



**DARDANIA**



**SHOQATA E PËLLUMBAVE AKROBATIKË TË KOSOVËS NË ZVICËR**

Bernë 29/04/2011

## **Përfaqësues të shoqatës "Dardania" priten nga ambasadori i Kosovës në Bernë, zotëri Naim Mala**

Me ftesën e ambasadori fuqiptotë të Kosovës në Zvicër, zotëri Naim Mala, më 29 prill 2011, përfaqësuesit e Shoqatës së Kultivuesve të Pëllumbave Akrobatikë të Kosovës në Zvicër "Dardania" ishin mysafirë në lokalet e mabasadës së Kosovës në Bernë.



Ambasadori z. Naim Mala në mesin e përfaqësuesve të shoqatës "Dardania", nga e djathta Musa Sylejmani, Skender Ramadani, Sabit Salihu, Rushit Rushiti dhe Avni Muharremi

Ambasadori i Kosovës, zotëri Naim Mala, iu organizoi një pritje të ngrohtë e tejet vëllazërore përfaqësuesve të shoqatës "Dardania", në mesin e të cilëve ishin: Avni Muharremi, kryetar i shoqatës, Rushit Rushiti, sekretar, Skender Ramadani, Musa Sylejmani dhe Sabit Salihu, anëtarë, si dhe Arbër Rushiti.

Zotëri Naim Mala shprehu admirimin e tij për vullnetin e kultivuesve të pëllumbave shqiptarë në nënqiellin e Zvicrës, që edhe kësajherë të kontribuojmë në afirmimin tonë kombëtar aty ku jetojmë. Ai i njoftoi shkurt të pranishmit edhe mbi aktivitetin e ambasadës së Kosovës dhe konzullatave tona në Zvicër.

Kryetari i shoqatës "Dardania", zotëri Avni Muharremi, falenderoi nga zemra ambasadorin për ftesën e bërë si dhe për kohën që e gjeti për këta bashkatdhetarë, të cilët, pranë punëve të rënda, merren edhe me kultivimin e pëllumbave nga Kosova dhe viseve tjera shqiptare edhe këtu ku ata jetojnë, në Zvicër.



Z. Naim Mala me Rushit Rushitin dhe Arbër Rushiti

Gjatë këtij takimi foli edhe zotëri Rushit Rushiti, sekretari i shoqatës dhe njëkohësisht delegat i shoqatës "Dardania" në Federatën Zvicerane të Kultivuesve të Pëllumbave të Racës, i cili e njoftoi ambasadorin në pika të shkurtëra mbi aktivitetin e shoqatës si dhe të arriturat e saj. Ai tregoi se si në fillim këtu në Zvicër ishte një grup i vogël prej katër bashkatdhetarëve tanë të cilët merreshin vetëm me kultivimin e pëllumbave nga Kosova, Bajram Sopa, Agron Aliu, Remzi Shabani dhe Bajrush Banulla. Këtij grupi iu bashkangjiti pastaj edhe vet Rushiti në vitin 1998. Por, deri në vitin 2006 kultivuesit merreshin me këtë sport vetëm si hobi në mes shokësh. Por, më 2006 u shfaqën idetë për themelimin e një shoqate e cila do të prezantonte shqiptarët e Kosovës dhe pëllumbave tanë edhe në ekspozitat dhe garat ndërkombëtare. Që nga themelimi, shoqata pati një aktivitet të dendur, duke arritur që edhe të anëtarësohet në Federatën Zvicerane të Pëllumbave të Racës e pastaj edhe duke marrë pjesë në Ekspozitën Kombëtare të Pëllumbave në Zvicër me dy lloje të pëllumbave nga Kosova, më 2010 në Hutwil. Ambasadorin e njoftoi sidomos për pëllumbin akrobatik të Kosovës, emrin e të cilit mban shoqata.

Pas një bashkëbisedimi me përfaqësuesit e shoqatës "Dardania", ambasadori i Kosovës, z. Naim Mala ofroi gatishmërinë e ambasadës së Kosovës për ta ndihmuar shoqatën sa herë që ajo të ketë nevojë për përkrahje institucionale.